



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 20
Prishtinë, më 09 tetor 2013, në orën 10:00, salla S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Adem Grabovci, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Imri Ahmeti dhe Bali Muharremaj.

Të ftuar: Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm, Kosum Aliu -Njësia qendrore harmonizuese e auditimit të brendshëm –Ministria e Financave.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.10.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit për vitin 2012;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.10.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 2 tetor 2013.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit për vitin 2012

Kryetari – Ishte i mendimi se para se të lidhet libër Raporti duhet të shqyrtohet nga Komisioni, sepse ndryshimet që do të propozohen në Komision do të duhej të inkorporoheshin. Në disa pjesë të raportit auditori i ka rekomanduar Qeverisë dhe Kuvendit. Kuvend për ZAP-in është KMFP. Ju mund të bëni propozime. Qeverisë i ndan detyra Kuvendi dhe Kuvendi është ai i cili mban përgjegjësinë Qeverinë. Ndërsa këshillat janë të mirëseardhura. Këto ndoshta janë gabime teknike, por si të tilla duhet korrigjuar. Sa i përket Raportit thuhet se gjatë vitit 2012 janë kryer 89 auditime të rregullsisë të organizatave buxhetore dhe se dy prej tyre janë institucione jashtë buxhetore. Opinionet e dhëna nga këto auditime janë: 37 opinione të pa kualifikuara, 42 opinione të pa kualifikuara me theksim të çështjes, 2 opinione të kualifikuara, 5 opinione të kualifikuara me theksim të çështjes dhe 3 mohim të opinionit. Sipas Raportit të ZAP-it, të hyrat në buxhet - të realizuara ishin 98.8% e planit në fillim të vitit, ndërsa realizimi i buxhetit ishte në 94.7% e ndarjes buxhetore, çka nënkupton se përkundër deficitit buxhetor të projektuar prej 3.3 milionë euro, në fund të mbylljes së vitit 2012 kishte suficit buxhetor prej 71.5 milionë euro. Brengos fakti se zbatimi i rekomandimeve të ZAP nga institucionet buxhetore është i mangët. Gjatë vitit 2012, kanë punuar 133 auditorë të brendshëm dhe një shumë e mjeteve të shpenzuar prej 1 milion euro. Marr në përgjithësi në menaxhimin e financave publike, edhe sipas këtij raporti, ekzistojnë probleme të theksuara të cilat janë në fushën e prokurimit, auditimit, regjistrimit e pasurisë, si dhe obligimet e papaguara nga viti në vit. Krahasuar me vitin e kaluar, ka progres në fushën e menaxhimit financiar, cilësia e auditimeve është më e mirë, e veçmas përmirësim i dukshëm vërehet në nivelin lokal. Aktualisht 32 auditorë të brendshëm duke përfshirë NJQH /AB janë të certifikuar, që përbejnë rreth 24% të auditorëve të brendshëm në OB. Grupi i dytë i auditorëve të brendshëm kanë filluar skemën e certifikimit në prill të vitit 2013. Megjithatë, ky certifikim duhet konsiderohet si standard minimal i aftësive dhe njohurive të nevojshme për praktiken e auditimit të brendshëm. Nevojiten trajnime të vazhdueshme për të mirëmbajtur dhe zhvilluar profesionalizmin. Të gjitha 22 Autoritetet Qendrore janë mbuluar me auditim të rregullsisë. Ato rezultuan në 14 Opinione të pakualifikuara dhe 10 Opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes. Po ashtu auditimin e rregullsisë për PVF në 26 Institucione të Pavarura dhe janë dhënë 24 Opinione të Pakualifikuara, ku 6 prej tyre janë me theksim të çështjes) dhe dy Opinione të kualifikuara (një prej tyre me theksim të çështjes). Ndërsa, në nivelin lokal ka kryer auditimin e të gjitha komunave (38) për vitin 2012. Nga këto, në 11 prej tyre janë kontraktuar kompanitë e njohura ndërkombëtare private të auditimit. Opinione të pa kualifikuara janë dhënë për 30 komuna (25 me theksim të çështjes), Opinione të Kualifikuara për pesë komuna, ndërsa për tri komuna është dhënë Mohim Opinioni. Në përgjithësi, kjo tregon përparim në krahasim me vitin e kaluar. Ndërmarrjet Shoqërore- riorganizimi i NSH Trepça është një sfidë për AKP-në. Mangësitë e identifikuara në AKP shkaktojnë pasiguri në riorganizimin e Trepçës dhe procesin e administrimit, dhe kanë një ndikim negativ në veprimtarinë e ndërmarrjes në të ardhmen. Mungesa e integritit dhe funksionimit të NSH Trepça si një e tërë, tregon se nevojiten përpjekje të mëtutjeshme nga ana e Bordit të AKP-se dhe të menaxhmentit të Trepçës për të siguruar raportim financiar të unifikuar, transparence dhe llogaridhënie në lidhje me aktivitetet e ndërmarrjes si një e tërë. Rekomandohet në këtë rast AKP, që në kuadër të ligjit të bëjë gjithçka drejtë një menaxhimi unik të kësaj ndërmarrjeje.

Përfaqësuesit e Kuvendit kanë ngritur disa vërejtje në lidhje me këtë raport, prandaj fjalën i dha zyrtarit koordinues me institucionet e pavarura në Kuvendin e Kosovës.

Fehmi Pireva, zyrtar koordinues me institucionet e pavarura në Kuvendin e Kosovës – Si zyrë kemi pranuar raportin e auditorit të përgjithshëm. Pas shqyrtimit të raportit ne kemi disa

vërejtje lidhur me këtë raport dhe atë me pjesën e rekomandimeve, konkretisht pjesa e parë e raportit. ZAP ka tejkaluar kompetencat sa i përket sugjerimeve dhe rekomandimeve për Kuvendin. Përfshirja e rekomandimit për Kuvendet komunale sa i përket dështimit të tyre në adresimin e rekomandimeve. Në këtë rast adresa për rekomandim do të duhej të ishte Ministria për administrimin e pushtetit lokal. Kompetencat e komunave janë të përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisjen lokale. Rekomandimi sipas së cilës ZAP-i i drejtohet Kuvendit që në kuadër të kuvendit të caktohet një zyrtar ekzekutiv, i cili duhet të jetë shërbyes civil. Kjo bie në kundërshtim me LSHC, si dhe me nenin 80 pika 3 të Rregullores, sipas së cilës sekretari i kuvendit është udhëheqës i Administratës së Kuvendit në varësi të Kryesisë. Përcjellja në mënyrë aktive e veprimeve të qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me ndërmarrjet publike. Kompetencat e qeverisë janë të përcaktuara, të ndara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Rregullat e bashkëpunimit dhe kompetencat në bazë të cilit funksionon Bordi i AKP-së, janë të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-034 për AKP, andaj është në mandatin e AKP-së se si do të nxjerrë rregullatorin për bashkëpunimin dhe funksionimin me palët me interes. Në pajtim me nenin 2 të ligjit AKP definohet saktë kompetenca e AKP -së se është e autorizuar për administrim, shitjen, transferimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve dhe në pajtim me nenin 20 të ligjit, ky institucion i raporton Kuvendit për aktivitetet e tij. Në kapitullin kur janë dhënë opinionet për institucionet dhe agjencive të pavarura, më pak është e theksuar forma e rekomandimit në drejtim të Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike, ndërsa ZAP është lëshuar në rrafshin e problemeve menaxheriale mbi bazën e të cilave nxjerr opinione. Kuvendit i intereson implementimi ose jo i rekomandimeve të ZAP-it.

Ramiz Lladrovci – Vlerësoi punën për Raportin vjetor të auditimit. Pajtohem me mendimin shqetësimet dhe vërejtjet e kryetarit, si dhe ndau mendim me përfaqësuesin e Kuvendit. Një pjesë e rekomandimeve janë të tejkaluara dhe duhet të rishqyrtohen edhe një herë.

Valbona Dibra – Nga raporti i vitit 2012 shihet se ka një menaxhim shumë të mirë të buxhetit për vitin 2012. Pranimet janë realizuar 98.8% në raport me buxhetin fillestar. Ndërsa pagesat në 94.7%. Procesi i raportimit është në përmirësim të vazhdueshëm, ku pjesa më e madhe e OB kanë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore lidhur me raportimin e jashtëm duke përfshirë raportet tremujore, nëntëmujore dhe vjetore. Raportin për obligime të papaguara, si dhe plane për adresimin e rekomandimeve. Përmirësime të vazhdueshme vërehen edhe te cilësia e informatave të prezantuara. Obligimet kishin rënë dukshëm. Nga 39 milionë, sa ishin në vitin 2011, në 26 milionë në vitin 2012, që d.m.th 33% janë zvogëluar obligimet. Kjo tregon se ka një forcim të kontrollit në plotësimin e pagesave. Të procesi i rekomandimeve, krahasuar me vitin e kaluar, vërehen përmirësime. Nga rekomandimet drejtuar Qeverisë 3 janë adresuar, ndërsa 4 janë në proces të adresimit. Ndërsa të autoritetet qendrore nga raportet individuale shohim se ekziston një gatishmëri e organizatave buxhetore për t'i përmirësuar ose për t'i adresuar rekomandimet. Nga 204 rekomandime, 160 janë adresuar, ndërsa vetëm 44 nuk janë adresuar. Nëse e shohim në përqindje shohim se 80% e rekomandimeve janë adresuar, një përmirësim ky krahasuar me vitin 2011. Për vitin 2011 është dhënë opinion i pakualifikuar ndërsa në vitin 2012 opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes është në diferencën në mes të regjistrimit të pasurisë dhe shpalosjen e tyre në pasqyrat financiare. Progresi i rekomandimeve nga viti i kaluar vërehet se rekomandimet e dhëna në vitin 2011 për menaxhimin e pasurisë janë në proces të adresimit. Sipas kësaj del se te menaxhimi i pasurisë kemi përmirësime. Nga kjo del se nuk ka konsistencë në dhënien e opinionit. Kërkoj sqarim lidhur me këtë mos konsistencë. Pastaj, një pjesë të komunave nuk auditohen nga ZAP, por nga kompanitë e kontraktuara private të auditimit. Këto kompani private të auditimit të kontraktuara nga ZAP, vazhdimisht japin mohim të opinionit ose opinion të kundërt. Ndërsa ZAP për komuna vazhdimisht jep opinion të pakualifikuar ose të pakualifikuar me theksim të çështjes. Pse ekziston një dallim në dhënien e opinionëve? A ka bërë ZAP një analizë të tillë dhe ku qëndron problemi?

Afrim Hoti – Lidhur me dhënien opinioneve me theksim të çështjes, kërkoi sqarim nëse është fjala për të njëjtën çështje. Pra është bërë theksimi i çështjes për të njëjtën arsye, ose për arsye të tjera, duke pasur parasysh që ka opinione të pakualifikuara, me theksim të çështjes për të njëjtën OB.

Murselj Haljilji – Theksoi se në faqen 20, ekziston realizimi i të ardhurave tatimore për ATK, përmenden në paragrafin 2, që arrin shuma në 104 milionë dhe llogariten për periudhën prej 2006, kurse gjatë këtij viti shuma 22 milionë është e pamundur të paguhet, sepse kalon pragun prej 6 vjetëve. Si do të jetë situata në vazhdim, si do të zhvillohet në vazhdim, a do të hyjnë këto borxhe në grupin e të paguarave. Sepse edhe në raport thuhet se mos vjelja e këtyre borxheve prezanton problem. Pyetja është: a ekziston rreziku konstant që këto borxhe të rriten?

Albert Kinolli – KMFP ka shtjelluar edhe më herët këtë material dhe çështjet që ka ngritur kryetari janë çështje që prezantojnë qëndrimin e përbashkët të Komisionit. Pastaj shqetësimet që u ngritën nga përfaqësuesi i Kuvendit. Kërkoi mendimin e auditorit të përgjithshëm rreth vërejtjeve të përfaqësuesit të Kuvendit se janë tejkaluar kompetencat e ZAP-it në dhënien e rekomandimeve.

Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – Tha se nuk ka për të shtuar asgjë raporti është kështu siç është. Kam dhënë opinionin tim për buxhetin e Kosovës, si dhe theksin e çështjes për trajtimin e disa pasurive. I kam vërejtur disa çështje që kanë të bëjnë me cilësinë informacionet në PF të cilat fryjnë shumë efektin e pasqyrave financiare. Kemi dhënë rekomandime si për Qeverinë, Kuvendin dhe Kuvendet komunale.

Kur kemi të bëjmë me autoritetet tatimore, ato prej vitesh janë munduar të krijojnë një sistem tatimor më të mirë në Kosovë. Ata kanë pasur problem me mbledhjen e borxheve. Që para dy vjetëve dhe vitin e kaluar kemi përmendur këtë problem dhe gjatë vitit 2012 kanë filluar projektet për këto borxhe, por sigurisht ato borxhe tani do të humbasin dhe kjo është një shumë e madhe e borxheve. Ata për momentin janë duke diskutuar me FMN për këtë dhe janë duke diskutuar me AKP-në, për sa i përket borxheve të ndërmarrjeve shoqërore. Po provojnë të arrijnë në njëfarë konkluzioni aty pasi që borxhet e ndërmarrjeve shoqërore janë mbi 300 milionë euro. Theksimi i çështjes në opinionin e dhënë – pasuritë - nëse nuk janë blerë gjatë vitit dhe nuk janë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në kuadër të regjimit atëherë UA që është duke u hartuar nga Qeveria janë kërkesa shtesë që duhet të kryhen në bazë të këtyre rregullave. OB po mundohen të kryejnë punën mirë dhe nëse do t'i mbledhim ato dhe nëse do t'i shihni mangësitë që dalin nga shifrat e atyre OB-ve do të shohim që shifra nuk është e njëjtë ashtu si informacioni që thesari e merr nga SIMFK-u. MF është e obliguar për të siguruar cilësinë e informacionit. Ky buxhet është i mbivlerësuar në disa fusha dhe i nënvlerësuar në disa fusha të tjera. Në përgjithësi PF në buxhetin e Kosovës janë të fryra për shkak të pasurive dhe për shkak të mos konsolidimit të dokumenteve në mes të OB-ve, kontabilitetit dhe kjo për Kosovën është e rëndësishme. Sa i përket komunave - jemi duke audituar të gjitha komunat dhe unë jam ai që jam përgjegjës edhe për auditimet e kontraktuara. Sipas Kushtetutës unë i raportoј Kuvendit, e jo këtij Komisioni. Unë rekomandoј Kuvendin që të marrë parasysh, nëse duhet të ndryshoj diçka ose jo. Pra, është Kuvendi ai i cili i pranon ose jo këto rekomandime. Raporti është final dhe i takon Kuvendit të marrë vendimin e tij.

Valbona Dibra – Tha se interesimet e saj kishin të bënin me atë se në raporte individuale thuhet që ka përmirësim në menaxhimin e pasurisë, ndërsa ZAP dhënë opinion të pakualifikuara me theksim të çështjes. Pse?

Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – Ka konsistencë në dhënien e opinioneve, sepse në rastin e parë flasim se OB-të janë duke trajtuar më mirë pasqyrat financiare, pastaj MF është përgjegjëse për sistemin e pasurisë dhe i dimë problemet e OB-ve me këto sisteme. Institucionet qendrore që janë përgjegjëse për gjithë sistemin e aseteve, ata duhet të zgjidhin

problemin për konsolidimin rreth asaj se çka flasin OB dhe çka niveli qendror. Për sa i përket rekomandimeve që i jap Qeverisë- nuk ka pengesë që të rekomandoj Qeverinë ose OB-ve, pastaj ju takon atyre nëse duan t'i trajtojnë ato ose jo. Pastaj është çështje e Kuvendit nëse duan të mbikëqyrin veprimet e qeverisë ose jo. Dua t'i kem me shkrim shqetësimet e sekretarisë së Kuvendit, në mënyrë që të jap përgjigje lidhur me këtë.

Kryetari – Kemi të bëjmë me rregulla të veçanta. Ka hapësirë që ZAP t'i adresojë më saktë rekomandimet. P. sh. keni dhënë një rekomandim për menaxher ekzekutiv në nivelin komunal. Kjo do të duhej t'i adresohet MAPL. Kuvendi duhet ta mbajë përgjegjëse Qeverinë për veprime. Nëse auditori nuk i raporton Komisionit, por vetëm Kuvendit atëherë duhet të konsultoj departamentin ligjor se nëse është kështu, atëherë pse duhet të vini këtu. Pastaj kam insistuar që përgjegjësi i agjencive të pavarura duhet të prezantojë vetë materialin në Kuvend. Ky material ka nevojë të korrektohet. Është formuar një Komision për harmonizimin e sistemeve të regjistrimit të pasurisë. Pjesë e këtij Komisioni është edhe ZAP. Përderisa, Komisioni ka insistuar në një sistem, por edhe ZAP është pajtuar që të jenë dy sisteme. Borxhet e këqija nuk janë detajizuar se sa është shuma e atyre borxheve të cilat i prët parashkrimi dhe sa janë parashkruar deri tani? Informatat lidhur me këtë është dashur të jenë më specifike, ndër vite. Borxhet ndaj kompanive publike dhe shoqërore sa është kredi dhe sa hua? Lidhur me këtë nuk kemi informata në raport. Edhe te kompanitë publike, të cilat i pret privatizimi e të cilat kanë borxhe. A kemi të dhëna rreth tyre?

Ramiz Lladrovci – Rekomandimet për Kuvendin janë jo saktë të adresuara. Nëse i lëmë të shkojnë si të tilla, atëherë nuk do të mund të përmbushen, sepse janë të pasakta. P.sh. ka shumë rekomandime për Kuvendin që kanë të bëjnë me AKP-në, atëherë ato do të duhej të përmbledheshin në dy rekomandime. Ka shumë komente në rekomandime e jo rekomandime të adresuara saktë. Pastaj, nëse kemi problem me ligjin, atëherë ligji duhet të procedohet në Kuvend dhe aty vijë në shprehje obligimi i Kuvendit. Ne punojmë mbi bazën e ligjit aktual.

Valbona Dibra- Nëse ne nuk jemi Kuvendi, atëherë kush është Kuvendi? Komisioni është trupë e Kuvendit dhe Kuvendi miraton atë që rekomandon Komisioni. Ky lëshim nuk duhet të bëhet herëve të tjera. Jam e vetëdijshme që zyra nuk ka kapacitet të mbulojë të gjitha auditimet e komunave dhe jemi të informuar që kontraktin kompani private të auditimit. Pyetja ishte nëse ZAP ka bërë ndonjë analizë rreth asaj se këto kompani japin mohim opinion ose të kualifikuara, ndërsa ZAP jep opinione të pakualifikuara ose me theksim të çështjes. Mendoj se ka nuk ka konsistencë në dhënien e opinionit. Thuhet që ka përmirësim në regjistrimin e pasurisë në krahasim me vitin 2011 dhe në vitin 2011 jep opinion të pakualifikuar, ndërsa në vitin 2012 ka përmirësim në menaxhimin e pasurisë dhe pikërisht theksimi i çështjes vihet te pasuritë. Jam dakord me konstatimet e anëtarëve të Komisionit lidhur me rekomandimet.

Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – Në Raportin vjetor të auditimit në përgjithësojmë atë çka kemi parë në auditimet individuale. Lidhur me borxhet tatimore specifikat do të mund t'i shohim me auditim të ATK-së. Ka të dhëna rreth borxheve të kompanive të cilat janë në prag të privatizimit, por ato të dhëna nuk janë të përfshira në raportin vjetor. Sa i përket ndërmarrjeve shoqërore mendoj që marrëveshja është dikur rreth 300 milionë euro. Ky është proces në vazhdim. Sa i përket pasurive përsëri nuk ndaj mendim me deputeten Dibra. Javën e kaluar jepnim disa faqe me komente për ta lidhur me këtë. Kemi pasur takime me të cilat po ndihmojmë për të pasur një regjim më të mirë të saj. Komenti ynë për UA është një punë në vazhdim dhe sigurisht ZAP do të jap këshilla. Gjithmonë mundohemi të ndihmojmë ministrinë kur mendojnë të ndërtojnë një sistem.

Në kushtetutë thuhet që unë i raportoj Kuvendit dhe mbahem përgjegjës nga Kuvendi. Pastaj sa i përket mënyrë se si i delegon detyrat Kuvendi është diçka tjetër.

Fehmi Pireva - Kuvendi ka një rregullore të punës dhe ka komisionet e tij përmes të cilave

kryhen punën. Komisioni funksional për një çështje del me rekomandime konkrete për Kuvendin.

Valbona Dibra - Komisioni nuk po konteston rekomandimet e auditorit dhe falënderon për këtë. Por ka përzierje të kompetencave. Rekomandimet se si ju keni adresuar Kuvendit është i pasaktë p. sh. rekomandimi që ka të bëjë me AQP i cili është në kuadër të MF. Rekomandimi është bërë për Kuvendin si vijon” *Kuvendi të marrë parasysh lehtësimin për futje të shpejtë të prokurimit elektronik...*’ rekomandimi është shumë i saktë, por lidhur me këtë duhet të rekomandohet Qeveria, e jo Kuvendi. Këto janë pushtete të ndara dhe këtë nuk e lejon ligji.

Ramiz Lladrovci- Në një rast thuhet” *Kuvendi duhet të nxisë prokurimin e centralizuar*” në këtë rast rekomandimi duhet të shkojë për Qeverinë, jo për Kuvendin. AQP është në kuadër të MF-së e jo në kuadër të Kuvendit. Pastaj, është çështje tjetër se si Kuvendi e mbikëqyrë këtë adresim.

Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm - Rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh lehtësimin e shpejt të prokurimit elektronik. Kjo sepse shtetet fqinje e kanë bërë tashmë këtë, ndërsa Kosova nuk ka bërë diçka të tillë. Ka një keqkuptim. Për mua është e njëjta gjë sa i përket këtyre rekomandimeve. Parlamenti ka votuar që AQP të jetë në kuadër të MF. Tani jemi në tetor 2013. Sa prokurime qendrore janë bërë deri tani? Asnjë! Vendimi i marr nga Kuvendi nuk është ndjekur nga Qeveria dhe në këtë rekomandoj që Kuvendi duhet të shtyjë prokurimin e centralizuar, sepse ata nuk janë duke bërë atë që ka kërkuar Kuvendi. MF është në dijeni për këtë.

Kryetari –Tha se Komisioni do të dalë me rekomandime konkrete si: të miratohet Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2012. Qeveria e Republikës së Kosovës, të ndërmarr masa për të zgjidhur mos pajtueshmërinë midis sistemit E- pasuria dhe SIMFK-së. Qeveria e Republikës së Kosovës, të hartojë plan konkret për trajtimin e borxheve të kompanive publike, para se ato të privatizohen. Qeveria e Republikës së Kosovës të nxisë prokurimin elektronik, si dhe prokurimin publik të centralizuar. Agjencia Kosovare e Privatizimit, të ndërmarr masa për të evituar mangësitë të cilat po shkaktojnë pasiguri në riorganizimin e ndërmarrjes Trepça, si dhe për të siguruar një raportim financiar të unifikuar të kësaj ndërmarrjeje, si një e tërë. Kuvendi të përshpejtojë miratimin Rregullores së Punës (si pasojë e të cilit shumë çështje të raportimit kanë mbetur të pa definuara saktë me rregulloren aktuale). Ministria e Financave të përkrah Organizatat Buxhetore me shtimin e numrit të auditorëve të certifikuar. Në mbledhje plenare të ftohet Auditori i Përgjithshëm, për të prezantuar Raportin Vjetor të auditimit për vitin 2012. Propozoi që raporti duhet të modifikohet në bazë të vërejtjeve që i ka ngritur stafi i Kuvendit.

Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – Ky është raporti im dhe si i tillë është i përfunduar. Komisionit i takon të marrin vendimet e tyre. Nuk kam mundësi, e as kohë, të ndryshoj raportin të cilin e kam kryer.

Kryetari - Qëndrimet e auditorit të përgjithshëm dhe të zyrës ligjore të Kuvendit nuk janë në pajtueshmëri dhe bazuar në këtë propozoi që mbledhja të shtyhet.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. *Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2012, shtyhet për mbledhjen e radhës.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.
E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu